

**RAPORTI I NDËRMJETËM**  
**15 maj – 1 qershor 2015**  
**4 qershor 2015**

**I. PËRMBLEDHJE**

- Zgjedhjet Vendore, për kryetarët e bashkive dhe këshillat bashkiakë do të zhvillohen më 21 qershor 2015. Këto janë zgjedhjet e para që do të zhvillohen për njësitë e reja të qeverisjes vendore miratuar nga parlamenti në 2014 dhe do të jenë 61 bashki të sapo krijuara, që zëvendësojnë 373 bashki dhe komuna.
- Pavarësisht se Kodi Zgjedhor ka një sërë mungesash dhe paqartësi në lidhje me zgjedhjet vendore, ai ofron një bazë të plotë ligjore për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, nëse zbatohet dhe respektohet plotësisht nga palët e përfshira. Ndryshimet ligjore të 2015-ës sigurojnë përfaqësim të barabartë gjinor në listat e kandidatëve.
- Përgatitjet për zgjedhjet vendore po vazhdojnë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-ja) po funksionon në mënyrë të hapur. Disa nga bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it ngritën shqetësime në lidhje me paanëshmërinë e institucionit. KQZ-ja ngriti 90 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-të), të cilat do të krijojnë 5,299 Komisione të Qendrave të Votimit. Disa KZAZ patën vështirësi në punën e tyre.
- Lista përfundimtare e zgjedhësve përfshin 3,370,206 zgjedhës. Në dy bashki, Prokuroritë e Rretheve po hetojnë rastet e shtimit të emrave në listat e zgjedhësve, të kërkuara nga auditit i KQZ-së.
- KQZ-ja regjistroi 63 parti politike, 37 nga të cilat garojnë si pjesë e koalicionit kryesuar nga Partia Socialiste, 15 garojnë si pjesë e koalicionit kryesuar nga Partia Demokratike dhe 11 parti që kandidojnë vetëm. Interpretimi i paqëndrueshëm i rregullave për regjistrimin e kandidatit mund të pengojë të drejtën e disa partive për të kandiduar.
- Fushata, e cila filloi përpara datës zyrtare të 22 maj-it, ka qenë përgjithësisht paqësore, por e përqendruar në akuza personale, veçanërisht nga partitë kryesore. Ka akuza për presion mbi nëpunësit shtetëror dhe shpërdorim të burimeve shtetërore. Zyrtarë të lartë nga Aleanca për Shqipërinë Europiane kanë shpërndarë certifikata për legalizimin e pasurisë gjatë disa aktiviteteve të fushatës.
- Lidhjet e medias me partitë e mëdha politike shkaktojnë ndërhyrje të drejtpërdrejtë në autonominë mediatike dhe vetë-censurim. Përdorimi i materialeve të prodhuara nga partitë politike për mbulimin e fushatës në lajme, përbën një shqetësim serioz midis palëve të përfshira. Kodi Zgjedhor u mundëson kandidatëve zgjedhore mbulim të paanshëm televiziv dhe radiofonik.
- KQZ-ja ka marrë 22 ankesa kundër vendimeve të KZAZ-ve, kryesisht në lidhje me regjistrimin e kandidatëve. Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit të Tiranës ka gjykuar 17

kërkesa ankimore kundër vendimeve të KQZ-së, dhe gjashtë vendime të apeluara të KQZ-së u lanë në fuqi.

## II. PARATHËNIE

Me ftesë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe bazuar në rekomandimet e Misionit të Vlerësimit të Nevojave të OSBE-ODIHR-it zhvilluar nga data 15 deri më 17 prill, Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR-it) ngriti një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ-në) më datë 15 Maj<sup>1</sup>. MVZ-ja drejtuar nga Ambasadorja Audry Glover, përbëhet nga ekipi kryesor me 16 anëtarë, me zyrë në Tiranë dhe nga 20 vëzhgues afatgjatë, të cilët u shpërndanë më datë 20 maj në të gjithë vendin. Anëtarët e Misionit vijnë nga 21 Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. OSBE/ODIHR u ka kërkuar Shteteve pjesëmarrëse të dërgojnë deri në 250 vëzhgues afat-shkurtër për të vëzhguar votimin, numërimin dhe nxjerrjen e rezultateve.

## III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet vendore të datës 21 qershor do të jenë të parat për të zgjedhur kryetarët e bashkive dhe këshillave vendor në 61 njësi të reja të qeverisjes vendore (NJQV), të cilat do të zëvendësojnë 373 bashki dhe komuna në vijim të reformës administrative 2014. Gjithashtu, këto do të jenë zgjedhjet e para që kur Këshilli i Bashkimit Evropian i dha Shqipërisë statusin e vendit kandidat për në BE, në qershor të 2014-ës. Këshilli theksoi se, prioritetet kyçe kanë ende nevojë të përmbushen, veçanërisht përsa i takon “reformës administrative dhe gjyqësore, luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe të drejtat themelore.”

Qeveria kryesohet nga Partia Socialiste (PS) me 65 vende, në koalicion me Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) me 16 vende dhe mbështetet nga parti të tjera. Opozita parlamentare kryesohet nga Partia Demokratike (PD) me 50 vende në parlament dhe mbështetur nga Partia Republikane e cila ka 3 vende.<sup>2</sup> Megjithëse, të gjitha partitë politike ranë dakord mbi nevojën për të ulur numrin e NJQV-ve, opozita dhe disa parti të tjera jo parlamentare pretenduan se procesi i reformës nuk ishte gjithëpërfshirës dhe ndarja e re administrative-territoriale u bë sipas linjave partiake, jo në të gjitha rastet u morën parasysh veçoritë e zonave të populluara nga minoritetet. Rrjedhimisht, reforma administrative u miratua nga parlamenti pa mbështetjen e PD-së.

PD-ja kundërshtoi ndarjet e reja bashkiake në Gjykatën Kushtetuese, e cila rrëzoi kërkesën ankimore në dhjetor 2014.<sup>3</sup> Në janar 2015, Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit të Tiranës (Kolegji Zgjedhor) shfuqizoi një vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së) për të mbledhur kërkesa nga grupet qytetare, mbështetur nga opozita, për mbajtjen e 130 referendumeve vendore për të kundërshtuar NJQV-të e reja.

Kur qeveria kundërshtoi ndaj një mungesë të supozuar të vullnetit politik për të kërkuar konsensus mbi reformat e rëndësishme, opozita bojkotoi parlamentin prej korrikut deri në dhjetor 2014, por me ndërmjetësimin e Parlamentit Evropian, opozita hoqi dorë nga bojkoti. Megjithatë mjedisi politik mbetet i polarizuar ndërmjet PS-së dhe PD-së dhe ekziston frika se mosbesimi politik i përhapur ndërmjet partive mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e zgjedhjeve.

<sup>1</sup> Raportet e misioneve të mëparshme të vëzhgimit të OSBE/ODIHR në Shqipëri gjenden në: [www.osce.org/odihr/elections/albania](http://www.osce.org/odihr/elections/albania)

<sup>2</sup> Partia për Drejtësi, Integritet dhe Unitet, që ka qenë partia e dytë me e madhe opozitare në parlament, u bashkua me koalicionin e kryesuar nga PS-ja për këto zgjedhje.

<sup>3</sup> Gjykata Kushtetuese i quajti kundërshtimet e PD-së të pabazuara dhe të motivuara politikisht. Nuk pati shkelje procedurale gjatë miratimit të ligjit dhe kundërshtoi argumentet për bashkimin jokushtetues të komunave apo përfaqësimin jo të barabartë të zgjedhësve të mundshëm.

#### IV. SISTEMI ZGJEDHOR DHE KUADRI LIGJOR

Kryetarët e bashkive dhe të këshillave vendorë zgjidhen me mandat katër-vjeçar. Kryetarët e bashkive zgjidhen me shumicë votash me një raund, ndërsa kryetarët e këshillave zgjidhen me lista të mbyllura, me sistem proporcional. Ndarjet administrative për zgjedhjet vendore janë territoret e bashkive. Në të gjithë vendin zgjidhen 1,595 këshilltarë dhe 61 kryetarë bashkie. Zgjedhjet vendore rregullohen nga një kuadër ligjor i plotë, kryesisht duke përfshirë Kushtetutën, Kodin Zgjedhor dhe Rregulloret e KQZ-së.<sup>4</sup> Kodi Zgjedhor u amendua gjerësisht në 2012 pas një procesi gjithëpërfshirës mbështetur nga partitë e mëdha. Këto ndryshime trajtuan një numër rekomandimesh të bëra më parë nga OSBE/ODIHR-i.<sup>5</sup> Amendamentet e Kodit Zgjedhor të bëra në prill 2015 pasqyrojnë ndarjen e re administrative dhe kuotat gjinore për këshillat u rritën në 50%, duke ndryshuar gjininë në çdo emër të dytë. PD-ja nuk i mbështeti amendamentet në lidhje me ndarjen e re administrative, por nënshkroi nenet mbi kuotat gjinore.

Disa prej rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it mbeten të patrajuara, përfshi masat për të rritur paanëshmërinë e komisioneve zgjedhore, transparencën e financimit të fushatës, dhe zgjedhjen efikase të mosmarrëveshjeve zgjedhore. Kodi Zgjedhor përmban një numër boshllëqesh dhe mospërputhje procedurale, duke përfshirë përcaktimin e një subjekti zgjedhor, Paqartësinë mbi mbledhjen e firmave mbështetëse dhe kërkesat për verifikimin e regjistrimit të kandidatit, dorëheqjen e kandidatit për kryetar bashkie, afatet e paqëndrueshme për shqyrtimin e kërkesave ankimore dhe pamjaftueshmëria e rregullave të fushatës.<sup>6</sup>

#### V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet Vendore u administruan nga tre nivele komisionesh, të përbërë nga KQZ-ja, 90 Komisione të Administrimit të Zonave Zgjedhore (KZAZ-të), dhe 5,299 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV-të). Numërimi kryhet nga Grupet e Numërimit (GN-të) në 90 Vende të Numërimit të Votave (VNV-të), të ngritura në 90 Zonat të Administrimit Zgjedhor (ZAZ-të).

KQZ-ja është një organ i përhershëm, përgjegjës për mbarëvajtjen e përgjithshme të zgjedhjeve. KQZ-ja përbëhet nga 7 anëtarë, të gjithë emërohen nga kuvendi. Tre anëtarë propozohen nga shumica parlamentare dhe tre propozohen nga opozita parlamentare. Kryetari i KQZ-së emërohet nga kuvendi, nëpërmjet një procesi të hapur aplikimi, i cili u zhvillua në vitin 2012.

KQZ-ja ka funksionuar në mënyrë të hapur, me seanca publike të ndjekura rregullisht nga vëzhguesit, media dhe përfaqësuesit e partive politike.<sup>7</sup> Në shumicën e rasteve, gjatë seancave ka patur diskutime thelbësore dhe gjithëpërfshirëse, ndonjëherë dhe diskutime të ndezura ndërmjet anëtarëve të KQZ-së dhe përfaqësuesve të partive politike. Disa bashkëbisedues të MVZ-ve të OSBE/ODIHR-it, kanë ngritur shqetësimin se KQZ-ja ka marrë vendime sipas linjave politike. Bashkëbiseduesit gjithashtu kanë deklaruar se administrimi zgjedhor mbetet akoma i ndjeshëm ndaj

<sup>4</sup> Legjislacioni tjetër përkatës përfshin Ligjin mbi Qeverisjen Vendore, Ligjin mbi Partitë Politike, Ligjin mbi Grevat dhe nenet e Kodit të Procedurës Administrative dhe Kodin Penal.

<sup>5</sup> Këto përfshijnë një proces të përzgjedhur të amenduar për anëtarët e administratës zgjedhore, duke përfshirë Kryetarin e KQZ-së, një proces të rishikuar për përpilimin e listës së zgjedhësve, një proces të thjeshtuar për regjistrimin e kandidatëve, dhe më shumë akses të barabartë medias dhe financimet publike të fushatës.

<sup>6</sup> KQZ-ja nuk adaptoi udhëzime të nevojshme për verifikimin e dokumenteve të kandidimit siç e kërkon Neni 73.6 i Kodit Zgjedhor përcjellë nga një udhëzim i KQZ-së së 2013-ës, i cili shqyrton kuadrin e veçantë ligjor për zgjedhjet parlamentare dhe nuk përfshin ndryshimet përkatëse në ligj.

<sup>7</sup> Në 8 prill, KQZ-ja adaptoi Rregullat e brendshme të Procedurave, me pikëpamjen për të përmirësuar kolegjalitetin midis anëtarëve të KQZ-së për vendimmarrje më të qendrueshme.

presionit politik dhe akoma nuk gëzon besim të plotë. Vendimet e KQZ-së jo gjithmonë janë publikuar brenda afateve të përcaktuara në faqen e saj zyrtare.<sup>8</sup>

KZAZ-të, të cilat janë krijuar më 13 Prill, përbëhen nga 7 anëtarë, të cilët caktohen nga shumica parlamentare dhe nga opozita. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vizitoi 72 KZAZ, të cilat duken se punojnë me nivele të ndryshme profesionalizmi dhe në një ambient të politizuar. Në disa raste, KZAZ-të kanë raportuar pengesa në punën e tyre.<sup>9</sup> Kështu, deri më datë 1 qershor, 129 nga 630 anëtarë të KZAZ-ve (20 përqind) janë zëvendësuar, kryesisht me kërkesë të partive që i emëruan.<sup>10</sup> Gratë janë më pak të përfaqësuara në KZAZ, duke përbërë rreth një të tretën e të gjithë anëtarëve. KQV-të, gjithashtu përbëhen nga 7 anëtarë dhe duhet të emërohen nga KZAZ-të jo më vonë se data 1 qershor, sipas së njëjtës formulë të përdorur për KZAZ-të.<sup>11</sup>

KQZ-ja prodhoi fletëpalosje për edukimin e zgjedhësve dhe postera në disa gjuhë minoritare, duke përfshirë gjuhën arumune, greke, maqedonase, rome dhe serbe. KQZ-ja, me ndihmën e Përfaqësisë së OSBE-së në Shqipëri, po drejton një program për edukimin e zgjedhësve për komunitetin Rom dhe Egjiptian në 7 zona në të gjithë vendin, dukë përfshirë çështje si rregjistrimin e zgjedhësve, procedurat e votimit, votimin familjar dhe blerjen e votës. KQZ-ja, gjithashtu, ka nxjerrë materiale për edukimin e zgjedhësve, për të promovuar pjesëmarrjen e gruas, personave me aftësi të kufizuara dhe zgjedhësve për herë të parë.

## VI. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Sistemi i regjistrimit të zgjedhësve është pasiv. Listat e Zgjedhësve (LZ-të) nxirren nga baza elektronike e të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC-së), që mbahet nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC-ja). Të gjithë shtetasit e moshës 18 vjeç ose më shumë gjatë ditës së zgjedhjeve kanë të drejtë vote, me përjashtim të atyre që janë shpallur të paafte mendërisht me vendim gjykate. Zgjedhësit e moshës 100 vjeç ose më shumë u hoqën nga lista e zgjedhësve, siç e kërkon ligji dhe duhet të konfirmojnë të dhënat e tyre për ri-përfshirje.<sup>12</sup>

Duke filluar që nga 14 janari, DPGJC-ja përditësoi çdo muaj LZ-të. Njoftimet mbi vendndodhjen e qendrave të votimit i dërgohen zgjedhësve deri në 16 mars. Ekstraktet nga LZ-të për çdo qendër votimi (QV-të) duhej të afishoheshin për publikun nga kryetarët e NJQV-ve. Sipas DPGJC, 3,370,206 zgjedhës u përfshinë në Listat Përfundimtare të Zgjedhësve (LPZ-ja). Deri në 18 maj, të gjitha KZAZ-të duhet të kishin marrë dy kopje të printuara të LPZ-ve për çdo QV dhe versionin e plotë elektronik të LPZ-së.<sup>13</sup> Zgjedhësit mund të kërkojnë ndryshime në të dhënat e tyre tek Zyrat e Gjendjes Civile deri në 18 maj, ku kërkesat, mund të regjistrohen në gjykatën e rrethit gjyqësor.<sup>14</sup>

<sup>8</sup> Neni 24.3 i Kodit Zgjedhor kërkon që vendimet e KQZ-së brenda 24 orëve të zbardhen dhe të publikohen menjëherë në faqen zyrtare të KQZ-së. Qysh nga shpallja e zgjedhjeve, KQZ-ja ka kaluar gati 570 vendimeve.

<sup>9</sup> Këto pengesa përfshijnë mungesën e pajisjeve, mjediset e përshtatshme, dhe mungesën e fondeve. Në disa KZAZ anëtarëve ju duhet të mbulojnë vetë shpenzimet.

<sup>10</sup> Pavarësisht nga rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it, partitë kanë të drejtë të kthejnë emërimet e tyre nga KZAZ-të në çdo kohë sipas gjykimit të tyre.

<sup>11</sup> KQZ-ja sanksionoi Kryetarë bashkie për krijimin e parakohshëm apo konfirmimin e qendrave të votimit

<sup>12</sup> Që nga 12 maji, nga 1,288 zgjedhës të regjistruar mbi moshën 100 vjeç konfirmojnë të dhënat e tyre.

<sup>13</sup> Disa ekipe monitorimi afat-gjatë raportuan se disa KZAZ nuk kanë marrë kopje elektronike të LPZ-të në afat. Dy kopje u printuan nga nëpunësit e gjendjes civile; një kopje është afishuar në cdo QV, ndërsa një tjetër do të përdoret në VNV-të ditën e zgjedhjeve. Ligji është i paqartë se kush është përfundimisht përgjegjës për dhënien e kopjeve elektronike të LPZ-ve KZAZ-ve.

<sup>14</sup> Nëse zgjedhësi ndryshon adresën pas datës 18 maj, ai duhet të votojë tek adresa që është i regjistruar në LPZ-ve.

Një nga dy audituesit të caktuar nga KQZ-ja, vuri re një rritje në numrin e zgjedhësve të regjistruar, me 2,186 në Durrës dhe 595 në Kavajë. Të dy rastet janë aktualisht nën hetim nga Prokuroritë e Rretheve

## VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Çdo qytetar me të drejtë vote mund të kandidojë në zgjedhje, përveç atyre që janë duke vuajtur një dënim me burg.<sup>15</sup> Kandidatët mund të propozohen nga partitë politike, koalicionet e partive, ose nga një grup zgjedhësish.

KQZ-ja regjistroi 63 parti, nga të cilat 37 parti janë pjesë e koalicionit Aleanca për Shqipërinë Europiane, kryesuar nga Partia Socialiste, 15 parti janë pjesë e koalicionit Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet, kryesuar nga Partia Demokratike dhe 11 parti që garojnë vetëm. Deri në 1 qershor, 36,250 kandidatët konkurronin për këshillat bashkiakë dhe 162 për kryetarë bashkie, duke përfshirë 16 gra. Procedurat e ankimimit për regjistrimin e kandidatëve, vijuan përgjatë javës së parë të periudhës së fushatës zyrtare duke dëmtuar mundësinë e një fushate të barabartë.

Subjektet Zgjedhore duhej të dorëzonin emrat e kandidatëve në KZAZ-të përkatëse deri në 4 maj.<sup>16</sup> Përveç partive apo kandidatëve të përfaqësuar në parlament apo qeverisje vendore, të gjithë konkurruesve të tjerë iu kërkohet të dorëzonin firmat mbështetëse nga të paktën një përqind të zgjedhësve nga bashkitë e tyre përkatëse.<sup>17</sup> Në 7 prill KQZ-ja, me vendimin e saj Nr.88, vendosi që konkurruesit zgjedhorë të përfaqësuar vetëm në komuna, duhet të mblidhnin firmat mbështetëse, me arsyetimin se komunat nuk njihen më nga Kodi Zgjedhor, si pasojë e reformës së NJQV-ve.<sup>18</sup> Në vijim të kësaj qasjeje, KQZ-ja nuk pranoi listën e kandidatëve të PSD-së për Bashkinë e Durrësit, për shkak të mungesës së firmave mbështetëse. Në 15 maj, ky vendim i KQZ-së u rrëzua pas apelimit nga Kolegji Zgjedhor, i cili vendosi që konkurruesve me mandate të çdo niveli, nuk iu nevojitej të mblidhnin firmat.

Regjistrimi i tre kandidatëve të tjerë të PSD-së, që së fundmi mbajnë mandate në komuna, por që gjithësesi dorëzuan firmat sipas vendimit Nr. 88 të KQZ-së, u sfidua nga PS-ja dhe LSI-ja, në bazë të pretendimeve për firma të manipuluar.<sup>19</sup> Në të dy rastet regjistrimi u mohua për shkak të një mungese apo dorëzimit me vonesë të certifikatave të mandatit, pavarësisht se kjo nuk përcaktohet në vendimin Nr.88 të KQZ-së.<sup>20</sup> Në një rast tjetër, KQZ-ja regjistroi kandidatin pasi certifikata u dorëzua në KZAZ përpara afatit ligjor. Megjithatë, Kolegji Zgjedhor shfuqizoi këtë vendim për shkak të mungesës së një vule në certifikatën e dorëzuar. Disa përfaqësues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën shqetësimin se ky interpretim i paqendrueshëm pengon zbatimin e rregullave për regjistrimin e kandidatit dhe pengon të drejtën e tyre për të kandiduar.

KZAZ-ja pranoi dorëheqjen e kandidatit për kryetar bashkie në Kurbin dhe rrjedhimisht regjistroi një kandidat tjetër nga e njejta parti. KQZ-ja e rrëzoi regjistrimin e kandidatit të dytë, për shkak të

<sup>15</sup> Edhe pse nuk është e rregulluar me ligj, çështja e kandidatëve me të dhëna kriminale, shpesh u ngrit në fushatë.

<sup>16</sup> KQZ-ja regjistron kandidatët dhe listat e kandidatëve në dhjetë bashki, që kanë më shumë se një ZAZ.

<sup>17</sup> Partitë dhe kandidatët e pavarur duhet të japin të paktën 50 firma. Përsa i përket partive, por jo kandidatëve të pavarur, ligji e përcakton me 3,000 firma, numri më i madh që nevojitet për regjistrim. Partitë dhe kandidatët për kryetarë bashkie, duhet të provojnë prezencën e tyre në parlament, këshill apo qeverisje me mandat të autorizuar.

<sup>18</sup> Në 18 prill, PSD-ja sfidoi vendimin e KQZ-së Nr.88, por Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit të Tiranës e rrëzoi çështjen me arsyetimin procedural pa koment në themel të vendimit.

<sup>19</sup> KQZ-ja dërgoi firmat në Ministrinë e Brendshme për hetim të cilët u përcollën Prokurorisë.

<sup>20</sup> PSD sfidoi pa sukses vendimin e KQZ-së me refuzimin e kandidatit të tyre në Prrenjas.

dorëzimit me vonesë të dokumentacionit. Kjo la vetëm një kandidat në garë për bashkinë. Kolegji Zgjedhor e shfuqizoi më vonë vendimin e KQZ-së me qëllim për të ofruar zgjedhje konkurruese dhe i kërkoi KQZ-së, të rishqyrtonte çështjen në themel, deri në 30 maj. Në 1 qershor, KQZ-ja shfuqizoi vendimin e KZAZ-së, për të pranuar dorëheqjen e kandidatit, duke e lejuar të konkurronte për zgjedhjet.<sup>21</sup>

## VIII. FUSHATA ZGJEDHORE DHE FINANCIMI I FUSHATËS

Ndërkohë që periudha zyrtare 30 ditore e fushatës filloi më 22 maj, partitë dhe kryetarët e tyre e nisën fushatën përpara kësaj date duke zhvilluar mitingje për të prezantuar kandidatët vendor dhe u shfaqën me reklama e postera në të gjithë vendin.<sup>22</sup>

Që nga 22 maj, intensiteti i aktiviteteve zgjedhore është rritur dhe mbetet i qetë, përveç disa incidenteve të izoluara. Ndërkohë që partitë e mëdha vijuan të përdorin metoda tradicionale të fushatës, duke përfshirë mitingjet, vizitat në çdo shtëpi, janë zhvilluar edhe fushata më modeste në formën e forumeve të vogla, ku kandidatët dhe qytetarët kanë ndërvepruar drejtpërdrejt. Janë zhvilluar debate midis kandidatëve për kryetarë bashkie në një numër bashkish, përfshirë Shkodrën dhe Beratin, duke tërhequr vëmendje të konsiderueshme në radhë të medias dhe publikut.

Shumica e kandidatëve për kryetare bashkie janë nga PS-ja, LSI-ja dhe PD-ja, si dhe një numër kandidatësh nga partitë e vogla dhe kandidatë të pavarur. Edhe pse këto janë zgjedhjet vendore, fushata po dominohet nga kryetarët e partive kryesore në vend. Fokusi i fushatës është përqendruar gjërësisht në problemet e vendit, si: nxitja e rritjes ekonomike, përmirësimi i shëndetësisë dhe arsimit, krijimi i mundësive të punësimit për të rinjtë dhe ulja e taksave për bizneset e vogla. PS-ja, është përqendruar veçanërisht në nevojën për të luftuar korrupsionin, ndërsa PD-ja, është përqendruar veçanërisht në largimin e njerëzve me precedentë penalë nga pozicionet e qeverisjes në të gjitha nivelet. Fushata, sidomos ajo e partive të mëdha është përqendruar në akuza personale dhe përpjekje për të diskredituar konkurrentë të tjerë.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka marrë raportime për një sërë akuzash për ushtrim presioni mbi nëpunësit shtetëror, përfshirë disa kërkesa për të marrë pjesë në aktivitete zgjedhore dhe kërcënime për heqje nga puna, nëse nuk votojnë për një kandidat të caktuar.<sup>23</sup> Keqpërdorimi i burimeve shtetërore si ndërtesat publike të cilat raportohet se janë përdorur për fushatën zgjedhore por edhe mësuesit dyshohet të jenë përdorur për të promovuar kandidatë të caktuar.<sup>24</sup> Personalitetet kryesore të Aleancës për Shqipërinë Europiane kanë shpërndarë certifikata pronësie gjatë aktiviteteve të fushatës, çka është përceptuar nga disa si presion mbi zgjedhësit.<sup>25</sup>

<sup>21</sup> Ligji nuk e rregullon dorëheqjen e kandidatëve për kryetar bashkie.

<sup>22</sup> Kodi Zgjedhor përfshin një sërë dispozitash, në veçanti ato që kanë të bëjnë me mbulimin e paanshëm në media, të cilat filluan në datën e hapjes së fushatës, me synimin për të krijuar një nivel konkurimi të njëjlojtë në garë.

<sup>23</sup> Si për shembull, MVZ të OSBE/ODIHR-it u informua nga kandidati për kryetar bashkie i PD-së, që kryetari i bashkisë së Elbasanit presupozohet se ka thirrur drejtorët dhe mësuesit e shkollës në zyrën e tij dhe i ka kërcënuar ata se do të humbin punët e tyre nëse nuk do të votojnë për të. Në 25 maj MVZ të OSBE/ODIHR-it u informua që nëpunësit e bashkisë ishin udhëzuar të merrnin pjesë në miting, kryesuar nga kryetari i LSI-së gjatë vizitës së tij në Kukës.

<sup>24</sup> Si për shembull, MVZ të OSBE/ODIHR-it u informua nga kryetari aktual i Bashkisë që kandidati i LSI-së për kryetar bashkie i ushtronte presion mësuesve për të promovuar kandidatët e Aleancës për Shqipëri Europiane.

<sup>25</sup> Për shembull, në 24 maj fotot e Z. Ilir Meta, kryetar i parlamentit dhe kryetar i LSI-së, duke shpërndarë certifikatat e legalizimit në Vorë, u transmetuan në televizion. Regjistrime të Z. Erion Veliaj kandidat për Kryetar Bashkie të Tiranës të Aleancës për Shqipëri Europiane, duke dhënë certifikatat e legalizimit u transmetuan në 23 dhe 26 maj.

Partitë politike mund të financojnë fushatën e tyre zgjedhore me kontribute të fondeve shtetërore, donacione private apo hua. Kandidatët e pavarur nuk kanë të drejtë të përfitojnë fonde shtetërore. Parlamenti caktoi një shumë prej 190 milion Lek (rreth 1.34 milion Euro<sup>26</sup>) të fondeve shtetërore për financimin e partive politike në 2015, dhe në 3 shkurt KQZ-ja miratoi shpërndarjen e këtyre fondeve.<sup>27</sup> Të gjitha partive dhe kandidatëve të pavarur u kërkohet të deklarojnë shumën e financimit privat që ata marrin dhe shpenzimet e kryera gjatë fushatës; gjithsesi, ligji nuk ofron raportim periodik mbi financimin e fushatës. Një kandidat i pavarur për kryetar Bashkie të Tiranës publikoi detaje të donacioneve financiare dhe atyre në natyrë në faqen e tij të internetit dhe u bëri thirrje edhe kandidatëve të tjerë të bëjnë të njëjtën gjë.

## IX. MEDIA

Mjedisi mediatic karakterizohet nga një numër i madh mediash që veprojnë në një treg të kufizuar të reklamave. Bashkëbiseduesit me MVZ-të e OSBE/ODIHR-it shprehën shqetësimin se, pronarët e mediave financojnë mediat e tyre nga kompanitë e tjera që zotërojnë për të promovuar interesat e biznesit personal me partitë kryesore politike. Lidhjet e medias me partitë politike ndërhyrjnë direkt në autonominë mediatike, duke shkaktuar vetë-censurim dhe një mungesë burimesh të pavarura lajmesh. Për më tepër, ndikimi i partive politike mbi tema të pasqyruara në media kufizon hapësirat për çështje më pak të politizuara të një rendësie publike.<sup>28</sup>

Televizioni publik, Radio dhe Televizioni Shqiptar (*RTSH*), konsiderohet gjërësisht një mbështetës i partisë politike në pushtet dhe nuk ka pavarësi mediatike. Shikueshmëria e tij vlerësohet të jetë nën 10 përqind.

Nuk ka ndërhyrje në lirinë e përdorimit të internetit ku niveli i përdorimit të tij është 60%.<sup>29</sup> Liria e internetit ndihmon në mënyrë të vazhdueshme në pluralism, duke dhënë autonomi më të madhe mediatike dhe hapësirë për këndvështrime alternative.

Kuadri ligjor për median ofron gjërësisht lirinë e shprehjes. Megjithatë, bashkëbiseduesit shprehën shqetësim se zbatimi i këtij kuadri po pengohet nga politizimi i transmetuesit rregullator të medias, Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA) dhe organet drejtuese të RTSH-së. Kodi Zgjedhor përfshin nene të detajuara mbi mbulimin e lajmeve në radio dhe televizion të konkurruesve zgjedhorë me kohë transmetimi të barabartë, caktuar në përputhje me përfaqësinë e tyre në parlament. Në vijim, konkurruesve u ofrohet kohë transmetimi pa pagesë dhe e drejta për blerjen e kohës së transmetimit.<sup>30</sup> Mbulimi i institucioneve shtetërore duke promovuar arritjet e tyre është në favor të partive që kryesojnë ato institucione, në përputhje me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it.

<sup>26</sup> 1 euro është afërsisht 140 ALL (lek shqiptare)

<sup>27</sup> Ligji mbi partitë politike ndan 70 përqind të financimeve vjetore publike për partitë politike midis partive parlamentare në proporcion me vendet e tyre në parlament; 20 përqind ndahet midis partive që kanë marrë më shumë se 10,000 vota në zgjedhjet e mëparshme parlamentare; 10 përqind ndahet midis partive që kanë marrë më shumë se 1 përqind të votave

<sup>28</sup> Në 12 maj, Përfaqësues të OSBE-së mbi lirinë e medias u bënë thirrje “politikanëve dhe biznesmenëve që të ndërpresin manipulimin në media dhe në institucione siç janë AMA, dhe të lejojnë gazetarët dhe profesionistët të bëjnë punën e tyre në mënyrë të pavarur dhe profesionale për të mirën e publikut Shqiptar.” Shih tek [www.osce.org/fom/156676](http://www.osce.org/fom/156676).

<sup>29</sup> Shih <http://www.internetworldstats.com/stats4.htm>.

<sup>30</sup> Transmetimi i kohës pa pagesë u vonua për gati 6 ditë dhe filloi më 28 maj.



Më 22 maj, Bordi i Monitorimit të Medias (BMM-ja) filloi dorëzimin e raporteve ditore të monitorimit sasior në KQZ për të zbatuar kërkesat ligjore.<sup>31</sup> MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua se ka mungesë stafi dhe pajisjeesh për të monitoruar në mënyrë të drejtë një numër të madh transmetuesish, veçanërisht ato të rretheve. Ndërsa Kodi Zgjedhor nuk kërkon monitorimin e tonit të mbulimit por, anëtarët e BMM-se e shohin këtë si mangësi. Në 1 qershor, KQZ-ja diskutoi me BMM- raportin e parë javor<sup>32</sup> dhe propozimin e saj për të gjobitur shtatë kanale televizive të cilat kanë dhënë shumë më tepër kohë transmetimi Partisë Socialiste. KQZ-ja vendosi të mos i gjobisë në këtë fazë dhe u kërkoi kanaleve televizive të korrigjojnë mungesën e balancës.

Përdorimi në lajme i materialeve për fushatë të prodhuara nga partitë politike përbën një shqetësim serioz në rradhët e komunitetit të medias. Kodi Zgjedhor lejon transmetimin e këtyre filmimeve nëse kanë shenja të qarta identifikimi, por në këtë mënyrë u jep partive politike qasje të drejtpërdrejtë në përmbajtjen e lajmeve duke krijuar paqartësi në ndarjen e caktuar mes përmbatjes mediatike dhe reklamës politike. Për më tepër, një vendim i KQZ-së i miratuar në vitin 2013 i cili thotë që mediat nuk mund të refuzojnë filmime nëse përputhen me kriteret teknike, interpretohet si një detyrim i stacioneve televizive për të transmetuar materiale të prodhuara nga partitë politike.<sup>33</sup>

Në 17 maj, MVZ-ja e OSCE/ODIHR-it nisi monitorimin cilësor dhe sasior të pesë stacioneve televizive ( TVSH-në, ABC News, News 24, Top Channel and Klan TV) dhe tre gazetave (Gazeta Shqiptare, Panorama dhe Shqip)

## X. ANKIMI NË RRUGË ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

Sipas Kodit Zgjedhor, vetëm subjektet zgjedhore kanë të drejtë të ankimojnë vendime të organeve të administratës zgjedhore. Zgjedhësit mund të apelojnë vetëm gabimet në LZ-të dhe grupet e vëzhguesve vendore mund të apelojnë vetëm vendimet që mohojnë akreditimin e tyre. KQZ-ja shqyrton të gjithë ankimet kundër vendimeve të KZAZ-ve dhe duhet të marrë vendim brenda dy ditëve.<sup>34</sup> Vendimet e KQZ-së apo mosmarrja e një vendimi mund të apelohet në Kolegjin Zgjedhor, vendimet e të cilit janë të formës së prerë.

Deri tani, KQZ-ja ka marrë 22 ankimime kundër vendimeve të KZAZ-ve, shumica në lidhje me regjistrimin e kandidatëve. Në disa raste, KQZ-ja shmangu marrjen e vendimeve përfundimtare dhe i ktheu ato në KZAZ. Në një rast, KQZ-ja kundërshtoi vendimin e saj fillestar për të kthyer regjistrimin e kandidatit pranë KZAZ-së dhe më pas e regjistroi kandidatin pas një apelimi të dytë të vendimit të KZAZ-së. Në shumicën e rasteve të vëzhguara, KQZ-ja nuk mundi të marrë vendime përfundimtare sipas afatit.

Kolegji Zgjedhor përbëhet nga tetë gjyqtarë të Gjykatës së Apelit, të zgjedhur me short përpara zgjedhjeve parlamentare 2013. Gjyqtarët vijojnë detyrën e tyre rregullisht në vendet në zona të ndryshme të vendit, gjë që mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të vepruar në kohën e duhur. Të gjitha rastet shqyrtohen nga pesë gjyqtarë në seanca me dyer të hapura; edhe pse ende sot, vendimet nuk janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Tiranë.

<sup>31</sup> Çdo anëtar i KQZ-së cakton një anëtar të BMM-së ndërmjet kandidatëve që propozohen nga media e OJQ-ve.

<sup>32</sup> Nga shtatë anëtarë të BMM-së, 4 prej tyre firmosën raportin.

<sup>33</sup> KQZ-ja informoi MVZ-ja e OSBE/ODHIR-it se [vendimi 503 i KQZ-së](#) nuk e detyron të transmetojë regjistrime të realizuara nga partitë.

<sup>34</sup> Neni 143/3 detyron KQZ-në të marrë vendim brenda 2 ditëve nga dorëzimi i ankimit, ndërsa neni 133 përcakton afatin 48 orësh nga momenti i kur vendimi i KQZ- së pranohet si ankimim.



Deri më sot, Kolegji Zgjedhor ka shqyrtuar 17 ankime kundër vendimeve të KQZ-së ose në shumicën e rasteve nuk ka arritur të marrë një vendim në lidhje me regjistrimin e kandidatëve dhe ka lënë në fuqi 6 vendime të KQZ-së deri më tani.

## **XI. VËZHguesIT VENDORË DHE NDËRKOMBËTARË**

Vëzhguesit mund të caktohen nga partitë politike, koalicionet e partive, dhe kandidatët e pavarur që sigurojnë se ata janë regjistruar si subjekte zgjedhore në KQZ. E drejta për të caktuar vëzhguesit brenda një koalicioni qëndron vetëm brenda koalicionit dhe jo brenda partive të tyre. Organizatat e vëzhguesve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, misionet diplomatike, media dhe organizatat e huaja kanë gjithashtu të drejtë të vëzhgojnë zgjedhjet. Që nga 1 qershori, KQZ-ja ka akredituar 78 vëzhgues.

## **XII. AKTIVITETET E MVZ-së së OSBE/ODIHR-it**

MVZ-ja e OSBE/ODHIR-it filloi aktivitetin e tij në Tiranë me një konferencë për shtyp më 15 Maj. Kryetarja e Misionit u takua me Presidentin, Kyeministrin, Kryetarin e Parlamentit, KQZ-në, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Gjykatën Kushtetuese, Prokurorin e Përgjithshëm dhe midis të tjerëve dhe me Kolegjin Zgjedhor. Gjithashtu, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ka vendosur kontakte të rregullta me administratën zgjedhore në të gjitha nivelet, institucionet qeveritare të përfshira në procesin zgjedhor, ashtu sikundër edhe me përfaqësues të partive politike, vëzhgues vendorë, media, shoqërinë civile dhe komuniteti ndërkombëtar.<sup>35</sup> Për vëzhgimin në ditën e zgjedhjeve, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it do të bashkojë përpyekjet me një delegacion nga Kongresi i Këshillit Evropian për Autoritetet Vendore dhe Rajonale.

*Versioni anglisht është i vetmi dokument zyrtar.  
Ky raport është i disponueshëm edhe në gjuhën shqipe.*

<sup>35</sup> MVZ-ja e OSBE/ODHIR-it dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri veprojnë vecmas sipas mandateve të tyre mandateve të tyre të përcaktuara.